



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.05.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3306/13, për z. Rasim Demiri – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i Hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Rasim Demiri – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Demiri është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme si Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.Sh. “Shabi Tours”.

Zyrtari i lartë z. Demiri, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është

bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Demiri ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për ti bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, që të shmanget gjendja e mundshme e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Demiri ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 1745/14) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja e biznesit privat N.Sh. "Shabi Tours".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

